



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 1048/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić Kryesuese, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi, anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Egzona Morina Xhemajli, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Skenderajt nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Skenderaj, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** i pabazuar apeli Anr.1048/2021 i datës 04.11.2021 i parashtruar nga kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Skenderajt Egzona Morina Xhemajli, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Skenderaj, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave në vendvotimet 2102B/02R, 2106B/03R, 2121B/01R, 2101X/03R, 2107B/03R, 2107B/04D, 2115B/03D.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Skenderajt Egzona Morina Xhemajli, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Skenderaj, në të cilën thekson se në rezultatet përfundimtare i mungojnë votat e saja nga të afërmit dhe të familjarëve të saj në vendvotimet: 2102B/02R, 2106B/03R, 2121B/01R, 2101X/03R, 2107B/03R, 2107B/04D, 2115B/03D. Andaj e njëjta kërkon rinumërim të votave nga këto vendvotime.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pabazuar**

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar ndonjë provë bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mungesë të votave, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin

konkret, paneli nuk mund të konstatoj se ka pasur mungesë të votave për kandidaten në fjalë, për faktin se thëniet e saja janë vetëm theksime dhe supozime në apel te cilat si të tilla ato pretendime nuk janë të konkretizuara me asnjë provë konkrete bindëse për atë çfarë pretendon ajo.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Egzona Morina Xhemajli, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Skenderaj, nuk është i bazuar me asnjë provë apo dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje apo parregullsi në vendvotimet e lartcekura.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.1048/2021 më datën 07.11.2021

**Kryesuese e Panelit**  
Milena Đerić



*Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.*